- Dorëzimi i sistemit. Pasi të gjithë proceset dhe funksionalitetet të jenë testuar dhe provuar dhe pasi të jetë realizuar dhe trajnimi i stafit, do të bëhet dorëzimi final i sistemit. Në dorëzimin final do të përfshihen të gjithë komponentët si dhe dokumentimi i të gjitha zhvillimeve, përmirësimeve, riorganizimeve dhe integritimeve përkatëse .

Faza VI – Mirëmbajtje e platformës

Mirëmbajtja do të realizohet për një periudhë 24 muaj nga data e marrjes në dorëzim (dorëzimi përfundimtar)

5. LOGJISTIKA DHE KOHA

5.1. Vendndodhja

Bashkia Tiranë.

5.2. Data e Fillimit dhe Periudha e Implementimit të Detyrave

Data e fillimit është data e nënshkrimit të kontratës dhe periudha e zbatimit të kontratës do të jetë 3 (tre) muaj nisur nga kjo datë për implementimin e detyrave dhe 24 (njëzetë e katër) muaj duke filluar nga data e marrjes në dorëzim, do të jetë periudha e mirëmbajtjes së tij.

6. RAPORTIMI

6.1. Kërkesat e Raportimin

Kontraktori do të paraqesë raportet e mëposhtme në Shqip në origjinal dhe 2 kopje:

1. **Raporti Fillestar** prej maksimumi 12 faqesh duhet të prodhohet pas 2 javësh nga fillimi i implementimit. Në raport Kontraktori duhet të përshkruajë gjetjet fillestare, progresi në mbledhjen e të dhënave, çdo vështirësi të pritura ose të hasura. Kontraktori duhet të vazhdojë me punën e tij derisa Autoriteti Kontraktues të dërgojë komente mbi raportin fillestar
2. **Drafti i raportit përfundimtar** i faqeve maksimale 12 (teksti kryesor, duke përjashtuar anekset). Ky raport duhet të dorëzohet jo më vonë se 2 javë para përfundimit të periudhës së zbatimit të detyrave.
3. **Raporti final** me të njëjtat specifika si drafti i raportit përfundimtar, inkorporimin e komenteve të pranuar nga palët në draft raport. Afati i fundit për dërgimin e raportit përfundimtar është 5 ditë pas marrjes së komenteve në draft raportin përfundimtar. Raporti duhet të përmbajë një përshkrim mjaftueshëm të detajuar.

6.2. Dorëzimi dhe Miratimi i Raporteve

Raporti i përmendur më sipër duhet t'i dorëzohet komisionit të përcaktuar për zbatimin e kontratës. Ky komision është përgjegjës për aprovimin e raporteve.

7. KOMUNIKIMI ME SISTEME TË TJERA

Platforma do të integrohet me sistemin e rekrutimit dhe sisteme të tjerë sipas kërkesave të autoritetit kontraktor, të cilët mbartin informacion të nevojshëm për komunitetin dhe grupet e interesit.

8. MIRËMBAJTJA

Periudha e mirëmbajtjes do të jetë 24 (njëzetë e katër) muaj nga data e marrjes në dorëzim.

Kërkesat e Përgjithshme:

- Stafi përgjegjës i Institucionit do të kryejë detyrat e përditshme funksionale që lidhen me funksionimin e sistemit.
- Aktivitetet e mirëmbajtjes për sistemin me të gjithë komponentët përbërës, duhet të kryhen nga Operatori Ekonomik.

Operatori ekonomik duhet të mundësojë:

- Identifikimin dhe diagnostikimin e detajuar për çdo problem apo keqfunksionim të komponentëve të sistemit apo të problemeve të sigurisë dhe të propozojë zgjidhjen përkatëse. Të marrë masat e nevojshme për zgjidhjen e problematikave dhe të informojë stafin e Institucionit.
- Në çdo rast duhet të paraqesë planin e ndërhyrjes dhe një raport të detajuar për të gjitha veprimet e kryera.
- Për çdo ndërhyrje kontraktori duhet të marrë aprovimin e Bashkisë Tiranë.
- Ruajtje dhe analizim të detajuar të log të aksesimit, ndryshimit dhe rasteve të tjera të ndërhyrjeve në system.

Shërbimet e Mirëmbajtjes

Kompania duhet të ofrojë shërbime të mirëmbajtjes sipas niveleve të shërbimit dhe metodikës të përshkruar më poshtë:

Shërbime të mirëmbajtjes parandaluese.

Operatori ekonomik duhet të ndërmarrë, në mënyrë periodike një herë në muaj Shërbime të Mirëmbajtjes Parandaluese për të gjithë komponentët e këtij projekti. Shërbimet Parandaluese, janë shërbime proaktive të cilat do të mundësojnë dedektimin në kohë të problematikave, dhe do mundësojnë ndërmarrjen në kohë të hapave rekuperuese, për të mos patur ndërprerje të shërbimit. Të gjitha shërbimet e mirëmbajtjes parandaluese do të kryhen pranë Bashkisë Tiranë, përveç rasteve kur në kontrate përcaktohet një vendndodhje e re për kryerjen e këtyre shërbimeve.

Shërbime Riparimi në vendndodhje

Operatori ekonomik duhet të jetë i disponueshëm gjatë interval kohor, nga e Hëna në të Premte, 8x5, për të ofruar Shërbime të Riparimit në përgjigje të “Alarmeve Madhore” të raportuara nga personeli i autorizuar i Autoriteti Kontraktor (“Emergency On-Call Hours”). Për këtë qëllim, me termin Alarm Madhor do të kuptohet parashtrimi i kërkesës për Shërbime Riparimi të ndërmarra në rast të keqfunksionimit të komponentëve të mbuluara, që i pengon ato të operojnë në përputhje me Specifikimet dhe shkaktojnë ndërprerje të menjëherëshme e të konsiderueshme të sistemit dhe që, nuk mund të shmangeshin me anë të ndërhyrjeve dhe riparimeve minore të kryera nga stafi teknik i Autoriteti Kontraktor dhe të rekomanduara nga operatori ekonomik. Problemet që nuk i përkasin “Alarmeve Madhore”, duhet të adresohen nën Shërbime të Mirëmbajtjes Parandaluese.

Njoftimi dhe Njohja e Alarmeve Madhore.

Stafi përgjegjes do të njoftojë operatorin ekonomik me telefon, postë elektronike ose duke sinjalizuar nëpërmjet një ndërfaqeje web të vënë në dispozicion, dhe do të presë të kontaktohet nga operatori ekonomik me telefon, gjatë “Emergency On-Call Hours”. Operatori ekonomik duhet të kontaktojë Autoritetin Kontraktor dhe të konfirmojnë marrjen e Alarmit Madhor brenda 15 minutave nga marrja e njoftimit nga personeli i autorizuar. Në momentin e njohjes së thirrjes nga operatori ekonomik, personeli i autorizuar do ta asistojë atë gjatë diagnostikimit të problemit të raportuar.

Përgjigja ndaj Alarmeve Madhore.

Nëse operatori ekonomik nuk mund të përcaktojë nëpërmjet informacionit të mbledhur nga Procedurat e Troubleshooting, shkakun e Alarmit madhor, atëherë ai duhet të dërgojë një Teknik Shërbimi brenda intervalit kohor prej 1 (një) ore nga momenti i marrjes së njoftimit

për Alarm Madhor. Me të mbërritur, tekniku i kompanisë do të mbështetet me asistencë nga personeli i autorizuar dhe do ti jepet liri veprimi në mjediset dhe sistemet e mbuluara, i shoqëruar dhe survejuar nga personeli i autorizuar, për të filluar menjëherë procedurat e diagnostikimit dhe riparimit.

Veprimtaritë e Diagnostikimit dhe Riparimit.

Me të mbërritur në vendndodhje tekniku i shërbimit duhet të fillojë procedurat e diagnostikimit dhe riparimit. Këto veprimtari duhet të vazhdojnë deri sa:

- (a) Alarmi madhor të jetë korrigjuar ose të jetë “zgjidhur në mënyrë të tërthortë”;
- (b) Tekniku të jetë zëvendësuar nga një person tjetër;
- (c) Operatori ekonomik të përcaktojë se problemi i raportuar nuk është shkaktuar nga ndonjë keqfunksionim i Sistemeve të mbuluara ose
- (d) Operatori ekonomik arrin në konkluzionin që diagnostikimi ose korrigtimi i mëtejshëm mund të shtyhet deri në mbërritjen e pjesëve të këmbimit.

Kompania duhet të krijojë / diskutojë me autoritetin kontraktor një axhendë periodike kontrollesh si më poshtë:

1. Javore
 - a. Kontroll i logeve të serverit
 - b. Kontroll i statistikave të storage (Used disk space etc)
 - c. Kontroll i statistikave për sistemin
 - d. Kontroll i disqeve për problem në rast nevojë
 - e. Të kryejë mirëmbajtje proaktive

2. Mujore.
 - a. Testim / kontroll i kompletuar i pjesëve më kritike të infrastrukturës së klientit.
 - b. Kontroll i detajuar i gjithë log-eve .
 - c. Rishikim i të dhënave mbi performancën e serverit
 - d. Rekomandime për upgrade të mundshme.

Operatori ekonomik duhet të dokumentojë çdo veprim, duke paraqitur gjendjen para dhe pas ndërhyrjeve si dhe duhet të marrë aprovimin e stafit përgjegjës për çdo ndërhyrje.

Përmirësime dhe azhornime

- Azhornime të sistemit kur ka ndryshime ligjore dhe proceduriale që hyjnë në fuqi, por jo vetëm.

- Azhornim dhe përmirësimin e sistemit në lidhje me sigurinë

Operatori ekonomik duhet te dokumentoje cdo veprim, duke paraqitur gjendjen para dhe pas ndërhyrjeve si dhe duhet të marrë aprovimin e stafit përgjegjës për çdo ndërhyrje.

Termet e Mirëmbajtjes:

- Kontraktuesi duhet të garantojë disponueshmërinë e mirëmbajtjes dhe shërbimeve të vazhdueshme (Marrëveshjen SLA) për tërë kohëzgjatjen e kontratës.

<i>Kategoria A (Kritik/ I Larte)</i>	<i>Kategoria B (I Mesem)</i>	<i>Kategoria C (I Ulet)</i>
Mos funksionimi i aplikacionit krijon apo rrezikon shumë aktivitetin normal	Mos funksionimi i aplikacionit krijon vonesa në aktivitetin normal	Mos funksionimi i aplikacionit pengon në mënyrë minimal aktivitetin
<i>Numri i përdoruesve të ndikuar</i>		
Mos funksionimi i sistemit ndikon një numër <i>shumë të madh</i> të përdoruesve	Mos funksionimi i sistemit ndikon një numër <i>të vogël</i> të përdoruesve	Mos funksionimi i sistemit ndikon pjesërisht në disa përdorues
<i>Pezullimi i punës</i>		
Mos funksionimi i sistemit pengon përdoruesit <i>të realizojnë pjesën më të madhe të punës së tyre.</i>	Mos funksionimi i sistemit pengon përdoruesit <i>të realizojnë pjesë te punës së tyre</i>	Mos funksionimi i sistemit pengon përdoruesit <i>të realizojnë disa pjesë të vogla të punës së tyre,</i>

<i>Zgjidhje alternative e përkohshme</i>		
<i>Nuk ka një mënyrë alternative</i> të përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit	<i>Ka pjesërisht një mënyrë alternative</i> të përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit.	<i>Ka një mënyrë alternative</i> të përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit.
<i>Koha e përgjigjes</i>		

o 10 min. për të kthyer përgjigje o Në vend brenda 1 ore.	o 30 min.për të kthyer përgjigje o Në vend brenda 2 orëve	o 60 min.për të kthyer përgjigje o Në vend brenda 4 orëve
Koha e zgjidhjes		
Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është 4 orë pas kërkesës.	Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është brenda 2 ditëve të punës.	Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është 10 ditë kalendarike.

9. PLANIFIKIMI I BUXHETIT PËR NDËRTIMIN E SISTEMIT

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia	Çmimi për Njësi	Vlera Pa TVSH
1	Platforma zyrtare në institucion (analizë,përmirësime, riorganizime, zhvillime të reja, integritime, testim, instalim)	shërbim	1		
2	Trajnimi i përdoruesve	ditë	2		
3	Mirëmbajtja e platformës	muaj	24		
Totali pa TVSH					
TVSH					
TOTALI ME TVSH (LEKË)					

10. AFATI KOHOR I IMPLEMENTIMIT TË PROJEKTIT

Nr.	Emërtimi i fazës / Periudha kohore	M1	M2	M3	M4-M27
I	Faza përgatitore për platformën	x			

II	Faza e përmirësimit, riorganizimit dhe zhvillimeve të reja	<i>x</i>	<i>x</i>	<i>x</i>	
III	Faza e integritimit dhe testimit të platformës			<i>x</i>	
IV	Trajnimi i përdoruesve			<i>x</i>	
V	Marrja në dorëzim			<i>x</i>	
VI	Mirëmbajtja e platformës				<i>x</i>

11. TË DREJTAT E KODIT TË APLIKACIONIT

Të gjitha të drejtat mbi kodin burim dhe çdo dokumentacion teknik (mënyrën e konfigurimit të aplikacionit skica, etj.) do t'i përkasin Autoritetit Kontraktor. Zgjidhja do të dorëzohet e shoqëruar me kodin burim të strukturuar dhe të komentuar, për sistemin në tërësi, së bashku me setin e dokumentacionit teknik. Kodi burim duhet të dorëzohet i plotë pas implementimit të ndryshimeve, zhvillimeve dhe i përditësuar sa herë që mund të bëhen ndryshime gjatë fazës së mirëmbajtjes, në fund të kësaj periudhe.

12. KËRKESAT FUNKSIONALE

Platforma zyrtare në institucion përbëhet nga dy module kryesore:

- Portali web tirana.al
- Portali i brendshëm intranet.tirana.al

Intranet është një rrjet privat, i cili është i aksesueshëm dhe në shërbim të stafit të bashkisë. Në të serviret një gamë e gjerë e informacioneve, të cilat ndahen ndërmjet strukturave të Bashkisë Tiranë.

Përmes intranet gjithashtu menaxhohet procesi i publikimit në faqen zyrtare të institucionit.

Website (ndërfaqet, menu-të, butonat dhe mesazhet që marrin përdoruesit e sistemit) janë në gjuhën shqipe dhe në gjuhën anglisht.

Përmirësime, riorganizime, integritet dhe zhvillime të reja të sistemit/aplikacionit/modulit

Gjatë kohëzgjatjes së kontratës mund të jetë e nevojshme që të realizohet shtimi/ndryshimi/azhurnime të platformës si në aspektin e sigurisë (dhe jo vetëm) në rastet kur rregullorë të reja hyjnë në fuqi, por dhe në funksionalitete apo module të tjera, të cilat kërkohen nga Autoriteti Kontraktues/përfituesi.

➤ **WEBSITE**

Më poshtë janë të detajuara të gjithë funksionalitetet e reja të portalit .

Harta e faqes dhe navigimi.

KËSHILLI BASHKIAK

Hapësirë e dedikuar për Këshillin Bashkiak, e cila do të ketë përmbajtjen si vijon:

- Kryetari
- Sekretari i Këshillit Bashkiak
- Anëtarët
- Komisionet e përhershme dhe të përkohshme të Këshillit Bashkiak
- Legjislacioni
 - Akte normative
 - Rregullore
- Agjenda e mbledhjeve
- Rregullorja
- Vendime (sipas viteve dhe me mundësimin e një motori kërkimi me terma të veçantë, subjekt, datë etj.)
- Njoftimet
- Informacion mbi dëgjuesat publike
- Rregjistri elektronik i shkresave (ankesa, kërkesa, peticione, sondazhe)

- Kontakto Këshilltarët
- Buletini
- Të tjera (Informacione të tjera shtesë që lidhen me aktivitetin e Këshillit Bashkiak)

NJËSITË ADMINISTRATIVE

Kjo hapësirë i dedikohet Njësive Administrative.

Mundësia e gjurmimit nëpërmjet hartës të njësivë administrative duke klikuar mbi emrin e Rrugës. Ky funksionalitet vjen si rezultat kërkesave të shumta qytetare në adresë të Bashkisë. Në klikim të rrugës qytetari do të ridrejtohet në seksionin e Njësi Administrative, i cili përmban rubrikat si vijon

Rreth NJA

- Numri i banorëve
- Numri i bizneseve
- Numri i familjeve
- Numri i administratorëve të pallatit, listë e administratorëve të pallateve dhe kontaktet.

Karakteristika të njësisë

- Hartë e njësisë administrative ku të pasqyrohen rrugët
- Atraksione- Hartëzim i atraksioneve
- Institucione arsimore
- Projektet dhe Investimet
- Numri i shërbimeve- Në këtë seksion qytetarët do të infomohen mbi shërbimet që ofron Njësia Administrative.
Listim i shërbimeve së bashku me formularët përkatës.

Lajme- Të rejtat e fundit nga Njësia

Administratori i njësisë- Jetëshkrimi dhe kontaktet e administratorit.

MENUJA KRYESORE

• ORGANET E QEVERISJES VENDORE

Menuja administrata dhe Qytetarët përbëhet nga këto nënmenu:

- **Këshilli Bashkiak**
 - Kryetari
 - Sekretari i Këshillit Bashkiak
 - Anëtarët
 - Komisionet e përhershme dhe të përkohshme të Këshillit Bashkiak
 - Legjislacioni
 - Akte normative
 - Rregullore

- Agjenda e mbledhjeve
 - Rregullorja
 - Vendime (sipas viteve dhe me mundësimin e një motori kërkimi me terma të veçantë, subjekt, datë etj.)
 - Njoftimet
 - Informacion mbi dëgjuesat publike të realizuara nga Këshilli Bashkiak, lidhur me çështje sensitive për komunitetin, përpara vendimmarrjes.
 - Rregjistri elektronik i shkresave (ankesa, kërkesa, peticione, sondazhe)
 - Kontakto Këshilltarët
 - Të tjera (Informacione të tjera shtesë që lidhen me aktivitetin e Këshillit Bashkiak)
- **Kryetari i Bashkisë**
 - Kryetari i Bashkisë
 - Nënkryetarët
 - Vendime
 - Udhëresa
- **Administrata**
 - Organigrama
 - Institucionet e varësisë/Agjencitë
 - Punësimi
 - Vende pune- Integrim me platformën e rekrutimit.
 - Praktika- Websiti tirana.al ofron mundësinë e aplikimit online për programet e praktikave pranë Bashkisë Tiranë.
Formate të definuara të formularëve të aplikimit për çdo program.
Rikonceptim i formularëve të aplikimit për programet e praktikave.
Të gjitha aplikimet shqyrtohen në panelin e menaxhimit (Intranet) nga stafi i Bashkisë Tiranë.
 - Projekte
 - Rezervim takimi Online- Moduli “Rezervim takimi online”, i mundëson qytetarëve që të rezervojnë një takim në Njësinë Administrative ku ata banojnë.
- **Të reja**
 - Lajme
 - Aktivitete
 - Aplikacione për qytetarin
- **Legjislacion**
 - Legjislacioni
- **Edukimi**
 - Çerdhe
 - Kopshte
 - Shkolla

Listimi dhe pasqyrim i institucioneve arsimore në hartë.

- **SHËRBIMET PUBLIKE**

- **Shërbimet**

- Karta e Qytetarit
- Legjislacioni
- Shërbimet tona

Në këtë nënmenu do të listohen të gjitha shërbimet publike së bashku me kartelat informative dhe formularët përkatës të shkarkueshëm. Bashkia Tiranë së bashku me njësitë Administrative të saj ofron rreth 160 shërbime publike.

- Kartela informative
- Gjurmo aplikimin
- Tirana Ime
- Numri i gjelbër
- Vlerëso shërbimin online
- Pyetjet më të shpeshta

- **E drejta e Informimit**

- Programi i Transparencës

Ristrukturim i programit të transparencës sipas formatit standard.

- Koordinatori për të drejtën e informimit
- Regjistri i kërkesave
- Buxheti
- Open Data

- **Të dhëna për shërbimet**

- Numri i Aplikimeve
- Raportime Javore
- Raportime Periodike

- **Njoftime/Publikime**

- Anketime
- Njoftime Publike

- **Kontakt**

- Ankesa, Sugjerime
- Stop Korrupsionit

- **KULTURA & SPORT**

- **Shkolla Qendër Komunitare**

- Shkollat

- **Aktivitetet Online**

- Yoga
- Turne Shahu
- Ec Vrapo Pedalo

- **Projekte Kulturore**

- Prioritete Kulturore
- Kalendari i aktiviteteve
- Aktivitete Kulturore
- Thirrje për aplikime
- Projekte të huaja

- **Trashëgimia Kulturore**
 - Mbi Trashëgiminë Kulturore
 - Trashëgimia Kulturore materiale
 - Trashëgimia Kulturore jo materiale
 - Prioritete
 - Aktivitete të Trashëgimisë Kulturore
 - Propozime për emërtime të pjesëve të territorit publik
 - Kontakt
- **Eventet**
 - Aktivitete me foto dhe video
- **TURIZËM**
 - **Historiku i Tiranës**
 - Tirana - Pak histori
 - Trashëgimia dhe Arkitektura
 - **Planifiko udhëtimin tënd**
 - Si të vish në Tiranë
 - 1,2,3 ditë në Tiranë
 - Guida dhe Itenerare
 - Harta e qytetit
 - Strolling Tirana
 - **Zbulo Tiranën**
 - Atraksionet në Tiranë
 - Muze
 - Galeri
 - Teatro dhe Kinema
 - Objekte religjioze (Harmoni religjioze)
 - Rrethinat e Tiranës
 - **Agrobiznes**
 - Agroturizëm
 - Restorante tradicionale
 - Punishte dhe artizane
 - **Ha, Pi, Bli**
 - Akomodim
 - Restorante
 - Bare
 - Jeta e natës
 - Zona shopping
 - **Aeroporte & Transport**
 - Aeroporte
 - Linjat Urbane
 - Terminale

- Stacionet Ecovolis
- **Kontakte dhe shërbime**
 - Emergjenca dhe Spitale
 - Info Point
 - ATM
 - Zyra Postare
 - Biblioteka
 - Udhërrëfyesit dhe Operatorët turistikë
 - Kontakto

*Informacion dhe hartëzim i pikave të interesit në Tiranë.

- **EKONOMI& BIZNES**

- **Biznesi**

- Investo në Tiranë
- Udhëzues për Start Ups
- Ekosistemi i Start-up
- Situata aktuale në Tiranën Urbane
- Zona Rurale e Tiranës
- Suport dhe këshilla

- **Taksimi**

- Llogarit detyrimet lokale- Nëpërmjet modulit të taksave qytetarët mund të përlllogarisin taksat e tyre si familjarë ose si pronar të një biznesi.

- **Mundësi financimi**

- Kredi të buta
- Grante

- **Projekte**

- **Diaspora dhe Migrimi**

- **ZËRI YT**

- **Zëri yt**

- Forum
- Planifikim dhe Zhvillim Territori
- Rinia
- Financim Projektsh- Qytetarët mund të aplikojnë për financimin e një projekti me anën e formës së aplikimit.
- Rrjeti i Vullnetarëve- Qytetarët të cilët dëshirojnë të bëhen pjesë e rrjetit të vullnetarëve të Bashkisë Tiranë mund të aplikojnë online në faqen tirana.al.
- Këndi i BE

- **HARTA E QYTETIT**

Moduli i hartës i ofron qytetarëve të marrin informacion mbi vendodhjen e shërbimeve apo pikave tursitike.

TË FUNDIT

APLIKIME & INFORMACIONE

Në këtë seksion pasqyrohen disa prej shërbimeve që ofrohen.

SHËRBIME NË HARTË

Në këtë seksion pasqyrohen në formë hartografike shërbime si:

- Administrata
- WiFi- Hapësirat publike ku ofrohet shërbimi i wifi
- Autobusat- Linjat urbane
- Kultura
- Restorante
- Harta e zyrave të gjendjes civile

Përmes pasqyrimit të zyrave të gjendjes civile në hartën administrative territoriale të Bashkisë Tiranë, qytetarët do të marrin informacione mbi vendndodhjet e zyrave dhe sporteleve të cilat operojnë fizikisht apo online.

EVENTET E KRYEQYTETIT

Kalendari i eventeve në Tiranë, përmes të cilit qytetarët informohen në çdo kohë se çfarë po ndodh apo do të ndodhë në ditët në vijim.

- **TWITTER**
- **YOUTUBE**

➤ HARTA E FAQES DHE NAVIGIMI(Portali në anglisht)

– ADMINISTRATION AND CITIZENS

Menuja administrata dhe Qytetarët përbëhet nga këto nënmenu:

- **Applications and Information**
 - Dependency Institutions and Agencies
 - Applications for the citizens
- **Legislation and Administration**
 - Mayor of Municipality
 - Deputy Mayors
 - Municipal Council
- **Activities and Publications**
 - Latest News & Events
- Education
 - Hartëzim i institucioneve arsimore**
 - Pre-kindergartens
 - Kindergartens
 - Schools
- **CULTURE & EVENTS**
 - Cultural Projects
 - Cultural Priorities

- Calendar of activities
 - Cultural Activities
 - Calls for applications
 - Foreign projects
 - **Culture Heritage**
 - On Culture Heritage
 - Tangible Culture Heritage
 - Intangible Culture Heritage
 - Priorities
 - Cultural Heritage Activities
 - Proposals for naming parts of public territory
 - Contact
 - **Events**
 - Photos & Videos from activities
- **TOURISM**
 - **Tirana History**
 - Tirana - Short Story
 - Heritage and Architecture Evolution
 - **Plan Your Trip**
 - Arriving in Tirana
 - 1,2,3 days in Tirana
 - Guides and Itinerary
 - City Map
 - Strolling Tirana
 - **Discover Tirana**
 - Theatres and Cinemas
 - Attractions and Sights
 - Museums
 - Galleries
 - Religious Objects (Religious Harmony)
 - Tirana Surroundings
 - **Agribusiness**
 - Agritourism
 - Traditional restaurants
 - Handicraft workshops
 - **Eat, Drink, Shop**
 - Accommodation
 - Restaurants
 - Bars
 - Nightlife
 - Shopping areas
 - **Airports and Transport**
 - Airports
 - Bus Lines
 - Terminals
 - Eco Volis Stations
 - **Contact and Utilities**
 - Emergencies and Hospitals
 - Info Points
 - ATM

- Post Offices
- Guides and tour operators
- Libraries
- Contact us
- **ECONOMY AND BUSINESS**
 - **Business & Financial Opportunities**
 - Invest in Tirana
 - Business Angels
 - **Projects**
 - Lana River
 - Swedfund project
- **CITY MAP**
 - **City Map**
 - Bars
 - Restaurants
 - Tourism
 - Culture
 - Transportation
 - Administration Offices
- **LATEST**
- **TIRANA MAYOR**
- **TWITTER**
- **Youtube**
- **SERVICES**
- **MAIN EVENTS**

➤ **PORTALI I BRENDSHËM**

Intraneti i Bashkisë Tiranë është konceptuar si një portal i brendshëm, i cili i vjen në ndihmë çdo punonjësi të Bashkisë Tiranë në varësi të pozicionit të punës.

Intraneti përbëhet nga dy komponentë kryesorë:

- **Faqja e brendshme e Bashkisë Tiranë**, e cila ofron informacione dhe shërbime të ndryshme për punonjësit e bashkisë. Stafi i Bashkisë Tiranë akseson informacione dhe shërbime të ndryshme në varësi të pozicionit të punës.
- **Paneli i menaxhimit**, i cili mund të aksesohet vetëm nga përdorues të autorizuar, të cilëve në varësi të rolit që kanë aksesojnë funksionalitete të ndryshme.

Gjatë fazës përgatitore do të përcaktohen saktësisht të gjitha ndryshimet, integrimet, përmirësimet dhe zhvillimet e reja , objekt kontrate.

Kërkesat për ndryshime, integritime, përmirësime dhe zhvillime të reja në portalin web për rrjedhë prej portalin e brendshëm nga ku menaxhohet i gjithë procesi.




Figure 1. Procesi i publikimit në website

Kërkesa të përgjithshme

- Mund të lindë nevoja që herë pas here të kërkohet azhornimin, përmirësimin apo modifikimin i sistemit duke u fokusuar por pa u kufizuar në:
 - Modifikim/shtim i moduleve.
 - Modifikim/shtim i menuve.
 - Azhornim, përmirësim apo shtim i rubrikave në hapësirën e Njësive Administrative.
 - Modifikim/shtim i formave në website.
 - Azhornim, përmirësim apo modifikim i forumit.
 - Modifikim/shtim i shërbimeve.
 - Përmirësimi i performancës së proceseve aktuale.
- Krijimi i proceseve/ objekteve të reja sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.
- Përditësime në rastet e ndryshimit të bazës ligjore dhe rregullatore.

13. KËRKESAT TEKNIKE

- Nisur nga rëndësia e kësaj platforme, sigurimi i vazhdimësisë së shërbimit nëpërmjet teknikave më moderne është primare për këtë projekt. Për rrjedhojë lind nevoja e përditësimit të teknologjive të përdorura në versionin e fundit.
- Sistemi do të hostohet në infrastrukturën ekzistuese, dhe do t'i vihet në dispozicion operatorit ekonomik fitues për konfigurimet përkatëse.

14. SHTOJCA

Formularët e praktikave

- **Aplikimi për praktikë mësimore:**
 - Tekst info para aplikimit:
 - Bashkia Tiranë ofron mundësinë e zhvillimit të praktikave mësimore, të cilat kryhen në kuadër të plotësimit të krediteve akademike.
 - Kujdes: Në fund të aplikimit do tu kërkohet të ngarkoni dokumentat e mëposhtëme:
 - CV
 - Kartë ID
 - Dëshmi penaliteti ose Formular i vetdeklarimit të gjendjes gjyqësore.
 - Kërkesë zyrtare nga fakulteti ose kartë student ose vërtetim student.

- Fushat për aplikim:
 - TË DHËNAT PERSONALE TË APLIKANTIT
 - Emri *
 - Atësia *
 - Mbiemri *
 - ID *
 - Adresa
 - Cel
 - E-mail *
 - Datëlindja *
 - Universiteti* :
 - Universiteti*
 - Vendas Publik
 - Vendas Privat
 - I huaj Publik
 - I huaj Privat
 - Viti*:
 - Programi*
 - Bachelor
 - Master Profesional
 - Master Shkencor
 - Fakulteti *:
 - Dega *:
 - Kërkesa:
 - Kërkoj të kryej praktikën në BT, për periudhën:
 - Data e fillimit *
 - Data e përfundimit *
 - Orët totale të realizimit të praktikës *
 - Pedagogu Udhëheqës
 - Emri i Pedagogut *
 - Mbiemri i Pedagogut *
 - Kontakti i Pedagogut *
 - Qëllimi i praktikës *
 -
 - Njësia Organizative:
 - Zgjedh të kryejë praktikën në: *
 - Referohu materialit përmbledhës të Organigramës dhe Rregullores të Bashkisë Tiranë Klike më poshtë:
 - Shkarko
 - Dokumentat e nevojshme për aplikim:
 - Curriculum Vitae *
 - Dokument identifikimi *
 - Kërkesë zyrtare nga fakulteti ose Kartë Studenti ose Vërtetim Studenti.
 - Dëshmi penaliteti / Formular i vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore. * (shkarko formularin).

- Dëshironi të informoheni mbi aktivitetet që zhvillon institucioni i Bashkisë Tiranë? *
 - Po
 - Jo

- **Aplikimi për praktikë pune:**

- Tekst info para aplikimit:
 - Bashkia Tiranë ofron mundësinë e zhvillimit të praktikave të punës, të cilat kryhen në kuadër të zhvillimit personal dhe profesional kryesisht gjatë periudhës Qershor – Tetor.
 - Kujdes: Në fund të aplikimit do tu kërkohet të ngarkoni dokumentat e mëposhtëme:
 - CV
 - Kartë ID
 - Dëshmi penaliteti ose Formular i vetdeklarimit të gjendjes gjyqësore.
- Fushat për aplikim:
- TË DHËNAT PERSONALE TË APLIKANTIT
 - Emri *
 - Atësia *
 - Mbiemri *
 - ID *
 - Adresa
 - Cel
 - E-mail *
 - Datëlindja *
 - Statusi i Studimeve: *
 - Jam duke ndjekur studimet në:
 - Kam përfunduar studimet në:
 - Universiteti* :
 - Universiteti*
 - Vendas Publik
 - Vendas Privat
 - I huaj Publik
 - I huaj Privat
 - Viti*:
 - Programi*
 - Bachelor
 - Master Profesional
 - Master Shkencor
 - Fakulteti *:
 - Dega *:
- Kërkesa:
 - Kërkoj të kryej praktikën në BT, për periudhën:
 - Data e fillimit *
 - Data e përfundimit *
- Qëllimi i praktikës (Kuotat e pranimit për praktikë pune janë të limituara) *

- Njësia Organizative:
 - Zgjedh të kryejë praktikën në: *
 - Referohu materialit përmbledhës të Organigramës dhe Rregullores të Bashkisë Tiranë Klike më poshtë:
- Dokumentat e nevojshme për aplikim:
 - Curriculum Vitae *
 - Dokument identifikimi *
 - Dëshmi penaliteti / Formular i vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore. * (shkarko formularin).
 - Dokument që vërteton kryerjen e studimeve *(Diplomë ose Kartë Studenti ose Vërtetim Studenti.
- Dëshironi të informoheni mbi aktivitetet që zhvillon institucioni i Bashkisë Tiranë? *
 - Po
 - Jo

-Fund-